



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	15. 03 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	1395/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.88/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën numër A.nr.88/2022 të datës 02.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga [redacted] kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike *“masë disiplinore-vërejtje me shkrim”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET si bazuar** ankesa me numër A.nr.88/2022 e datës 02.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. **ANULOHET** Vërejtja e datës 17.01.2022, përmes e-mailit të Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime Private të Sigurisë-Departamenti për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e shqiptuar ndaj ankuesit.
- III. **OBLIGOHET** Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për fshirjen e Vërejtjes të datës 17.01.2022 të shqiptuar nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë dhe largimin e saj nga dosja e ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas Ndryshimit të Akt emërimit me numër protokollit 118 të datës 06.02.2017 në vendin e punës *“Zyrtar i lartë për Standardizim, Trajnime dhe Licencim”*, në Divizionin për Shërbime Private të Sigurisë-Departamenti për Siguri Publike, me datë 17.01.2022 Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë gjegjësisht Udhëheqësi i Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë-Departamenti për Siguri Publike përmes formës elektronike e-mailit zyrtar i ka shqiptuar masën disiplinore *„Vërejtje”*, me arsyetimin se ankuesi ka bërë sjellje të pa rregullta gjatë komunikimit me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të tij, andaj me këtë raste i është shqiptuar vërejtje me shkrim, duke u bazuar në nenin 46 paragrafin 4 pika 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik,

duke kërkuar nga Njësia e personelit që vërejtja ti vendoset në dosje personale të tij. Vërejtja me shkrim përmes emalit është protokolluar me numër 40 me datë 20.01.2022.

Ankuesi kundër masës së shqiptuar-vërejtjes me shkrim, të datës 20.01.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 494/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendime ankimore se vërejtja me shkrim e shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtar Publik, duke i propozuar Këshillit që t'ia aprovojë ankesën dhe të anulojë vërejtjen me shkrim nga dosja personale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 08.02.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 22.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën Anr.88/2022 me numër protokollit 494/2022 të datës 02.02.2022; E-mailin e datës 17.02.2022 i protokolluar me numër 40 me datë 20.01.2022 lidhur me vërejtjen me shkrim; Ndryshim plotësim të Akte emërimit të datës 06.02.2017 me numër protokollit 118; Përgjigje në ankesë me datë 22.02.2022 nga Njësia e personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 16.06.2015 për ankuesin në pozitë "Zyrtar i lartë për Standardizim trajnime dhe licencim", në Divizion të Shërbimeve Private të Sigurisë - Departamenti për Siguri Publike; Përgjigje e datës 16.02.2022 nr. protokollit 199, në ankesë A.nr. 88/2022 të datës 02.02.2022 nga Udhëheqësi i Departamenti për Shërbimet Private të Sigurisë për Divizionin e BNJ; E-mail i datës 01.07.2020; E-mail i datës 30.06.2020; E-mail i datës 24.06.2020; E-mail i datës 23.06.2020; Njoftim për mes E-mail të datës 15.02.2022 për takimin e punës së Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë; Njoftim përmes E-mailit të datës 17.07.2017; Njoftim përmes E-mailit të datës 12.07.2017; Kërkesë përmes E-mailit të datës 05.07.2017; Njoftim përmes E-mailit të datës 05.07.2017; Kërkesë përmes E-mailit të datës 15.02.2022 për deklarime të takimit të mbledhur me datë 17.01.2022, të bashkangjitur dhe e-mailat e tjerë datës 15.02.2022 duke bashkangjitur dhe procesverbalin i nxjerra nga fletorja e takimit të datës 14.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e anekseve ka konstatuar se Udhëheqësi i Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë-Departamenti për Siguri Publike me date 17.01.2022 përmes formës elektronike e-mailit zyrtar i ka shqiptuar masën disiplinore „Vërejtje me shkrim” ankuesit Liridon Keka me pretendimin se ankuesi me veprimin e tij ka kryer shkelje të lehte të disiplinore sipas nenit 46 paragrafit 4 nën paragrafit 4.3 Ligjit nr. 06/L – 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës respektivisht sjellje e parregullt gjatë komunikimit me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të tij gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe përgjegjësisive të e tij, konkretisht ka neglizhuar punën lidhur me lëndën e kompanisë private të sigurimit SH.P.K. "Panther", e cila ka aplikuar me datë 08.12.2021 për licencë për shërbimin e sigurimit të tubimeve publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Udhëheqësi i Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë-Departamenti për Siguri Publike me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „Vërejtje me Shkrim” të datës 17.01.2022 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil respektivisht duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me dispozitat e Ligjit nr. 06/L – 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, nenin 45 ku përgjegjësia disiplinore është përcaktuar si në vijim: **Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja**

e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit” andaj ne rastin konkret në bazë të provave të lëndës këto dispozita nuk janë zbatuar, sepse nuk është vërtetuar saktë ndonjë veprim i paligjshëm i ankuesit apo qellim jo i mire me rastin e interesimit për dosjen e kompanisë private të sigurimit SH.P.K. ”Panther”, e cila ka aplikuar me datë 08.12.2021 për licencë për shërbimin e sigurimit të tubimeve publike, përkundrazi ankuesi është interesuar lidhur me fazat e shqyrtimit të kësaj lende sepse ankuesi për një periudhë ka qenë ne pushim vjetor andaj nuk e ka ditur se a është shqyrtuar lënda, andaj Kolegji konstaton ankuesi nuk ka treguar neglizhence por ka treguar gatishmëri në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës të ankuesit dhe organit të punësimit gjegjësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të bazuara sepse Udhëheqësi i Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e shqiptimit të vërejtjes me shkrim përmes e-mailit zyrtar ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 si dhe me nenin 48 paragrafin 2 që rregullojnë formën dhe elementet e aktit administrativ, sepse rrjedhimisht masa disiplinore „Vërejtje” përmes e-mailit gjegjësisht dokumenti elektronik si forme e shkruar nuk është përmbushur sepse nuk përmban te gjitha elementet e aktit administrativ respektivisht nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike, nuk përmban pjesën hyrëse, arsyetimin dhe udhëzimin për mjetet juridike apo këshillën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka marrë për bazë se arsyetimi i një akti administrativ me shkrim, do të duhej të ishte i bazuar në dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: **“1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:.....2.shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marre vendimi”**, që në rastin konkret Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „vërejtje” me shkrim ndaj ankuesit për mes E-mailit të datës 17.01.2022 e protokolluar me numër 40 me datë 20.01.2022, nuk ka marrë për bazë këto dispozita, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë çështje juridike, është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore **“vërejtje”**, e datës 17.01.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit, është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse nuk është shqiptuar në raport të drejtë me shkëljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: **“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkëljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”**, e që në rastin konkret nuk është vërtetuar shkëlja e pretenduar nga ana e udhëheqësit të ankuesit, nuk ka dëshmuar me prova se ankuesi e ka ngritur zërin me një tonë të lartë kumbues dhe kërcënues, po ashtu ankuesi nuk është informuar lidhur me shkëljen e supozuar krejt kjo është në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, 2, 3 dhe nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 si dhe nenin 13 paragrafin 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të „vërejtjes”, së datës 17.01.2022, e shqiptuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka konstatuar se e njëjta është nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. në të cilin përcaktohet se: **“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkëljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”**, pasi që nuk përmban te gjitha elementet e aktit administrativ, konkretisht nuk përmban pjesën përmbyllëse apo udhëzimin lidhur me këshillën juridike për palën dhe si i tillë edhe është i paligjshëm dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në diapozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.88/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.